



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

K U V E N D I

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 13.12.2019

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

RAPORT

PËR VLERËSIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 12.12.2019, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Projektligji është pjesë e paketës së projektligjeve financiare që shoqërojnë projekt buxhetin 2020.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 5 dhjetor 2019. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 32-38 dhe 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e komisionit ishin të pranishëm për të dhënë shpjegime mbi projektligjin Zv. Ministri i Financave Z. Elton Haxhi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

II. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat përpara fillimit të shqyrtimit nen për nen të paketës fiskale, më datë 10.12.2019, organizoi një seancë dëgjimore me gjithë grupet

e interes, ku morën pjesë, përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë, Shoqëritë e autoizuara për pajisjet fiskale. Gjatë kësaj seance dëgjimore, përfaqësuesit e dhomave të tregtisë dhanë vlerësimet dhe opinionet e tyre për ligjin e fiskalizimit dhe paketën fiskale në tërësi.

Pas konsultimit me grupet e interes, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, mori në shqyrtim projektligjin nën për nën dhe në tërësi duke dëgjuar vlerësimet e relatorit dhe qëndrimet dhe opinionet e anëtarëve të tij lidhur me to.

Më konkretisht, Komisioni, vlerësoi të drejtë dhe dakortësoi propozimin për saktësimin e vlerës së amortizuar të automjeteve të klasifikuara si “Automjet luksoz”, çdo vit me 10% të vlerës së mbetur dhe përcaktimin e parimit se vlera e shitjes së këtyre automjeteve nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar. Në këtë kontekst, për shkak të nevojës për përditësime në sistemin informatik dhe hapjen e zyrave edhe në rrethe të tjera për të qenë sa më afër taksapaguesve, komisioni vlerësoi të drejtë dhe miratoi edhe ndryshimin nga 0% në 5% të nivelit të komisioneve në favor të DPSHTRR e cila vepron në cilësinë e agjentit të taksave.

Një element tjetër që u vlerësua i drejtë ishte edhe unifikimi i masës së gjobës për rastet e moskryerjes së pagesës së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, me përcaktimet e ligjit për procedurat tatimore, duke përcaktuar që masa e gjobës nga 5% e shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit, të bëhet 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer dhe në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Komisioni dakortësoi me propozimin e Këshillit të Ministrave lidhur me unifikimin edhe të përqindjes së të ardhurave vjetore të mbledhura nga kjo taksë që i kalojnë pushtetit vendor, nga 18 % në 25%, duke vlerësuar dhe shprehur bindjen se në këtë mënyrë jepet një kontribut shtesë për të ndihmuar shtimin e buxhetit të njërive vendore çfarë përkthehet më pas, në investime dhe përmirësim shërbimesh për qytetarët.

Dakortësi pati edhe propozimi për riklasifikimin e taksës që vilet nëpërmjet pullës, duke përcaktuar si të tillë vetëm taksën e akteve të gjendjes civile.

Një element që u vlerësua pozitivisht dhe pati dakortësinë e plotë të anëtarëve të komisionit lidhet me propozimin e bërë nga Këshilli i Ministrave, për përjashtimin nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura të personave me aftësi të kufizuar. Komisioni për Ekonominë dhe Financat u shpreh se përmes kësaj nisme lehtësohet akoma më shumë nga barra fiskale, kjo kategori vulnerable e cila ka nevojë për një kujdes të veçantë e specifik.

Pavarësisht vlerësimit pozitiv të propozimeve të sipërcituara, Komisioni për Ekonominë dhe Financat nuk dakortësoi propozimin për përjashtimin nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura dhe taksa e përvitshme dhe e regjistrimit të mjeteve luksoze, të automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi. Për Komisionin për Ekonominë dhe Financat, kjo nismë konsiderohet e parakohshme, pasi Shqipëria akoma nuk ka rritur nivelin për koleksionimin e automjeteve të tillë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni mori në analizë edhe një amendament të propozuar bazuar në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit nga deputeti Z. Vullnet Sina, lidhur me një ndryshim në pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, duke propozuar ndryshimin nga 5% në 10% të nivelit të taksave të mbledhura nga renta minerare në favor një njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ky amendament nuk u miratua në komisioni për shkak se u vlerësua se burimet natyrore të vendit dhe ndaj të cilave aplikohet renta minerare, pavarësisht pozicionit gjeografi se ku ato ndodhen, janë dhe konsiderohen si burime kombëtare dhe si të tilla duhet të mblidhen dhe administratohen nga pushteti qendror.

III. Përfundime

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me votat pro të shumicës së gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, me ndryshimet e mëposhtme:

- Në nenin 2, të projektligjit, në shkronjat “a” dhe “b”, pas fjalëve “zëvendësohen me”, shtohet fjala “fjalët”.
- Në nenin 5, të projektligjit shkronjat “b” dhe “c” hiqen. Për këtë shkak neni 5 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 5

Në nenin 9, pika 1, shkronja “ç”, pas fjalëve “invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë” shtohen fjalët “personat me aftësi të kufizuara”. ”

- Neni 6, i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje: *“Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.*

RELATOR

Anastas ANGJELI

KRYETAR

Arben AHMETAJ